



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 13938 Pr

Fier më 05.12.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 108 datë 05 12. 2025

“Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028, përfundimtar dhe miratimin e Buxhetit të Vitit 2026, për Bashkinë Fier”

Në mbështetje :

Të nenit 9, pika 1.3, shkronja “c”, nenet 34, 40, 41, 54, shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; kreu III, nenet 10–20; kreu IV, nenet 22–29; kreu VII, nenet 39–41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV”; Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2025, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026–2028”, me shtojcat përkatëse; Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026–2028”; Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15867 datë 06.11.2025, protokolluar me tonën 12757, datë 10.11.2025 “Dërgohet për njoftim Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme për vitin 2026”; Dëgjuesat publike të organizuara në bazë të kalendarit, relacionin shoqërues të administratës së Bashkisë Fier, Kryetari i Bashkisë Fier;

PROPOPOZON

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për vitet 2026–2028, dhe Buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë Fier.
 - a. Të miratojë tavanet për çdo program për vitet 2026–2028, sipas tabelës PBA1 dhe programeve buxhetore të detajuara.
 - b. Të miratojë të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme dhe tre vitet e ardhshme, sipas tabelës PBA2.
 - c. Të miratojë detajimin e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik, funksional dhe sipas programeve, për vitet 2026–2028, sipas tabelave PBA3, PBA4 dhe PBA5.
 - d. Të miratojë qëllimet, objektivat, deklaratën e politikës si dhe shpenzimet për çdo produkt për çdo program për vitet 2026–2028, sipas tabelave PBA6, PBA7 dhe PBA9.
 - e. Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike për çdo program, sipas tabelës PBA8.
 - f. Të miratojë fondet buxhetore sipas programeve për vitet 2026–2028, sipas tabelës BV1.

- g. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Fier dhe institucioneve vartëse për vitin 2026, sipas tabelës BV5.
- h. Të miratojë shpenzimet e Bashkisë sipas klasifikimeve buxhetore, sipas tabelës BV6.
- i. Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike sipas programeve dhe burimeve të financimit, sipas tabelës BV7.

2. Tabelat shoqëruese:

- a. Lista e njësive shpenzuese të Bashkisë Fier, sipas tabelës BV-9.
- b. Përmbledhja e pagesave të vonuara dhe masat për likuidimin e tyre, sipas tabelës BV-11.
- c. Projekti i planit të arkës për vitin 2026 dhe PBA 2026–2028, sipas tabelës BV-15.

3. Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë:

- a. Rishpërndarja e projekteve të investimeve brenda të njëjtit program;
- b. Rishpërndarja e shpenzimeve korrente brenda programit;
- c. Rishpërndarja ndërmjet njësive shpenzuese për brenda të njëjtit program.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe institucionet vartëse të Bashkisë Fier.

Drejtoria e Financës

Buxhetit dhe Kontabilitetit

Fraverë Cina
Drejtoria e Menaxhimit Financiar
Pagesave Sociale

Drejtoria e Administrimit dhe
Menaxhimit të Pronës

Drejtoria e Mbledhjes së të Ardhurave

Drejtoria e Planifikimit të Territorit

Florjan Troka

Drejtoria e Hartimit të Projekteve
Publike dhe Kontrollit të Puneve

Silvana Basha

Drejtoria e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile
Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Turizmit

Artyrë Jula

Drejtoria Juridike

Emeralda Lapllanaj

Drejtoria e Sherbimit të Mbrojtjes

nga Zjarri dhe Shpetimi

Tarion Rexho
Drejtoria e Kontabilizimit të të Ardhurave
nga Taksat dhe Tarifat

Drejtoria e Ndjekjes së Kundervajtjeve

Administrative dhe Policia Bashkiake

Drejtoria e Bujqësisë dhe Veterinarisë

Qutë Lako

Qendra e femijeve me Aftësi ndryshe

Emri Luli

Qendra Ekonomike e Arsimit

Silvana Jaze

*Ndermarrja e Menaxhimit te Parqeve
dhe Gjelberimit*

Luolovik TARAJ

*10010
24/2 10/1*

Ndermarrja e Sherbimeve Publike

Arjan Ndreu

[Signature]

*Ndermarrja e Kanaleve Kulluese
dhe Vaditese*

Entela Fole

Ndërmarrja e Pastrimit dhe Higjenës

Emiliona Nënmet

**Kryetar i Bashkisë
Armando Subashi**

